481. Në qarkullimin e gjakut proteina hemoglobin lidhet me :

- A) CO^2
- B) H_2O
- C) H_2
- D) O^2

482. Në fund të ovogjenzës, sa qeliza vezë formohen:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

FARMAKOLOGJI

483. A është e vërtetë se tabletat janë;

- A) ekstrakte alkalike
- B) pluhura të komprimuara në makineri të posaçme
- C) forma farmaceutike të buta që përdoren për lyerjen e lëkurës
- D) tretësira ujore që përdoren me anë të aparateve të posaçme

484. A është e vërtetë se rrugë natyrale e marrjes së barit është ajo;

- A) Subkutane
- B) Intramuskulare
- C) Intravenoze
- D) Inhalatore

V1

485. A është e vërtetë se gjate administrimit te barit me rrugë intravenoze;

- A) efekti I barit është I ngadaltë
- B) efekti I barit është I kontrollueshem
- C) nuk mund te japim sasi te madhe bari
- D) reaksionet anafilaktike jane me te lehta

486. A është e vërtetë se gjate administrimit te barit me rrugë intramuskulare vendi me I shpeshte I aplikimit të injeksionit ne femijet e vegjel eshte muskuli;

- A) deltoid
- B) ventrogluteal
- C) dorsogluteal
- D) vastus lateralis

V1

487. A është e vërtetë se potencimi realizohet midis dy barnave ;

- A) qe kane veprim ne te njejtin drejtim
- B) me efekte kualitativisht te ndryshme
- C) qe kane efekte te kunderta
- D) te gjitha keto thenie jane te verteta
- E) asnjera nuk është e vertete

488. A është e vërtetë se takifilaksia është ;

- A) Intolerance e lindur e organizmit ndaj nje bari te caktuar
- B) Fenomeni I mbarimit te shpejte te efektit te nje bari ndonese administrimi I tij vazhdon
- C) Forme e veçante e ambientimit
- D) Ndjeshmeria e rritur e fituar e organizmit nga marrja e perseritur e barnave

489. A është e vërtetë se adrenomimetiket shkaktojnë;
- A) Mioze
 - B) Ngushtim të bronkeve
 - C) Rritje të levizshmërisë së zorrëve
 - D) Nxitje të sistemit nervor qendror

V2

490. A është e vërtetë se adrenomimetiket nuk duhen dhënë në të semuret;
- A) Astmatike
 - B) Bradikardike
 - C) Me arrest kardial
 - D) Hipertonike

V2

491. A është e vërtetë se adrenalina nuk duhet kombinuar me;
- A) Betablokuesit
 - B) Analgjeziket opioide
 - C) Benzodiazepinat
 - D) Barbiturate

492. A është e vërtetë se alfa-adrenoblokuesit përdoren për mjekimin e ;
- A) Hipotensionit
 - B) Takikardisë
 - C) Insuficiencës kardiake
 - D) Depresionit

493. A është e vërtetë se efekti anesor kryesor i alfa-adrenoblokuesve është;
- A) Hipotensioni i theksuar postural
 - B) Retensioni urinar
 - C) Diarreja

D) Dhimbje artikulare

494 A është e vërtetë se beta-blokuesit përdoren për mjekimin e;

- A) Podagres
- B) Diabetit
- C) Takiaritmive
- D) Bronkitit kronik

495 A është e vërtetë se beta-blokuesit kundersindikohen në ;

- A) Insuficiencën kardiake
- B) Hypertension
- C) Takikardi
- D) Në sëmundjen migrenoze

496 A është e vërtetë se kolinomimetiket shkaktojnë

- A) Midriaze
- B) Ulin djersitjen
- C) Bradikardi
- D) Bronkodilatacion

497 A është e vërtetë se kolinomimetiket përdoren për mjekimin e;

- A) Glaukomes
- B) Astmes bronkiale
- C) Bradikardive
- D) Diarëve acute

498 A është e vërtetë se kolinomimetiket kunderindikohen ne;

- A) Bradikardi
- B) Retensionin urinar
- C) Hipertireoze
- D) Artritin rheumatoid

499 A është e vërtetë se M-kolinoblokuesit shkaktojnë

- A) Mioze
- B) Shtim te sekrecioneve bronkiale
- C) Bronkodilatacion
- D) Bradikardi

500 A është e vërtetë se M-kolinoblokuesit perdoren per mjekimin e ;

- A) Kolikes renale
- B) Glaukomes
- C) Hipertrofise se prostates
- D) Hipertermise

501 A është e vërtetë se M-kolinoblokuesit kunderindikohen ne;

- A) Ulceren peptike
- B) Parkinson
- C) Bradikardi
- D) Atonite intenstinale

V2

502 A është e vërtetë se efekti anesor kryesor që vihet re gjatë përdorimit të miorelaksanteve është;

- A) Apnea
- B) Hipertensioni
- C) Hipernatremia
- D) Hipotermia

503 A është e vërtetë se morfina shkakton;

- A) Midriaze
- B) Frenim të qendrës së frymëmarrjes
- C) Shton oreksin
- D) Diarë

504 A është e vërtetë se aspirina përdoret për mjekimin e;

- A) Ethes reumatizmale
- B) Për uljen e temperaturës në moshat pediatrike
- C) Insuficiencës renale
- D) Parkinsonit

505 A është e vërtetë se aspirina kundërlindkohet në;

- A) Hipertension
- B) Uljen e temperaturës
- C) Dhimbjet e kokës
- D) Ulcerën gastro-duodenale

V1

506 A është e vërtetë se bari I zgjedhur për mjekimin e atakut gutoz është;

- A) Allopurinoli
- B) Probenicidi
- C) Sulfipirazoni
- D) Kolkicina

V2

507 Cili nga keto barna anestezik jep rritje te tensionit arterial;

- A) Tiopentali
- B) Midazolami
- C) Ketamina
- D) Fentanyli

508 A është e vërtetë se benzodiazepinat shfaqin efekt;

- A) Eksitues
- B) Hipertensiv
- C) Myorelaksant
- D) Anksioz

509 A është e vërtetë se barbiturate kunderindikohen ne:

- A) Epilepsi
- B) Porfiri
- C) Hypertension
- D) Takikardi

510 A është e vërtetë se bari I zgjedhur per mjekimin e statusit epileptic është;

- A) Acidi Valproik

- B) Karbamazepina
- C) Diazepami
- D) Trimetadioni

511 A është e vërtetë se antipsikotiket kunderindikohen ne;

- A) Parkinson
- B) Alzheimer
- C) Skizofreni
- D) Ne pacientet me te vjella

512 A është e vërtetë se kriperat e litiumit perdoren per mjekimin e ;

- A) Epilepsise
- B) Parkinsonit
- C) Gjendjes maniakale
- D) Miastenise grave

513 A është e vërtetë se kofeina perdoret per mjekimin e;

- A) Insuficiences acute cirkulatore
- B) Hipertensionit
- C) Takikardise
- D) Hipertireoze

514 A është e vërtetë se glukozidet kardiake perdoren per mjekimin e ;

- A) Hipertensionit
- B) Insuficiences kardiake
- C) Fibrilacionit ventricular

D) Perikarditit adeziv

515 A është e vërtetë se glukozidet kardiake kunderindikohen ne:

- A) Flaterin atrial
- B) Fibrilacionin atrial
- C) Infarktin e miokardit
- D) Takikardine paroksizmale supraventrikulare

516 A është e vërtetë se kinidina perdoret per mjekimin e ;

- A) Aritmive atriale
- B) Astmes bronkiale
- C) Parkinsonit
- D) Epilepsise

517 A është e vërtetë se bari qe preferohet ne aritmit e shkaktuara nga helmimi me digitalike

është;

- A) Verapamili
- B) Amidaroni
- C) Difedani
- D) Lidokaina

518 A është e vërtetë se bari qe preferohet ne mjekimin e krizes anginoze është;

- A) Propanololi
- B) Kinidina
- C) Digoksina
- D) Trinitrina

V3

519 Cili nga barnat kalciblokues mund te perdoret edhe si antiaritmik

- A) Nifedipina
- B) Verapamili
- C) Amlodipina
- D) Nikardipina

520 A është e vërtetë se diuretiket osmotike perdoren per mjekimin e;

- A) Hipertensionit
- B) Edemave cerebrale
- C) Sindromin nefrotik
- D) Asnjera nga keto thenia nuk është e vërtetë

521 A është e vërtetë se diuretiket tiazidike kunderindikohen ne;

- A) Hipertoni
- B) Insuficiencen renale
- C) Edemen kardiake
- D) Edemen hepatike

522 A është e vërtetë se A.C.E. inhibitorët kunderindikohen ne ;

- A) Hipertension
- B) Diabet
- C) Hiperkalemi
- D) Insuficiencë kardiake

V2

FIZIOLOGJII 1

523. Nyja sinoatriale:

- A) prodhon impulse me frekuence normale
- B) eshte udheheqesja e ritmit te zemres
- C) vendoset ne pjesen e pasme te atriumit te djathte
- D) asnje nga te mesipermet

524. Nuk ben pjese ne sistemin konduktor te zemres:

- A) tufa e Hisit
- B) nyja nderatriale
- C) nyja atrio-ventrikulare
- D) pema Purkinje

525. Ne derivacionin e pare te Elektrokardiogrames

shprehet lidhja e :

- A) dora e majte me kemben e djathte
- B) dora e majte me doren e djathte
- C) komba e majte me kemben e djathte
- D) komba e majte me doren e djathte

526. Cila pjese e zemres funksionon si pacemaker duke derguar impulse:

- A) nyja sino atriale

- B) nyja atrio ventrikulare
- D) fijet Purkinje
- D). tufa e Hissit

527. Ne derivacionin e trete te Elektrokardiogrames shprehet lidhja e:

- A) dora e majte me kemben e majte
- B) dora e djathte me kemben e majte
- C) komba e djathte me doren e djathte
- D) komba e djathte me doren e majte

528. Nyja atrio-ventrikulare:

- A) prodhon impulse me frekuence normale
- B) eshte udheheqesja e ritmit te zemres
- C) vendoset ne pjesen e pasme te septumit nderventrikular
- D) asnje nga te mesipermet

V2

529. Toni I pare I zemres ka vecorite e meposhtme ,pervec njeres:

- A) eshte ton i forte
- B) eshte ton I zgjatur
- C) eshte ton I dobet
- D) eshte ton sistolik

530. Hematokriti është:

- A) vëll. eritrocitar / vëll. leukocitar, i shprehur në përqindje
- B) numri absolut i eritrociteve në gjak
- C) vëll eritrocitar / vëll. e përgjith

531. C'iloj imuniteti japin vaksinat:

- A) imunitet artificial të fituar pasiv
- B) imunitet natyral aktiv
- C) imunitet natyral pasiv
- D) imunitet artificial të fituar aktiv

532. Lloji i qelizës së bardhë të gjakut që lidhet me reaksionet alergjike është granulociti që quhet:

- A) bazofil
- B) eozinofil
- C) neutrofil
- D) Monocit

533. Individet me grupin e gjakut AB kanë:

- A) vetëm antigenin B
- B) vetëm antigenin A
- C) antigenet A dhe B
- D) asnjërin prej tyre

534. Cili nga perberesit ushqimor eshte me i rendesishem per prodhimin e eritrociteve:

- A) Ca
- B) Na
- C) proteinat
- D) vitamina B12 dhe ac. folik

535. Volum Tidal quhet:

- A) kapaciteti vital
- B) Volumi inspirator rezerve
- C) ajri respirator
- D) te gjitha te mesipermet

536. Cili nga te meposhtmit eshte funksion i membranesh qelizore:

- A) .inicion transduksionin e sinjalit
- B) transporton jone dhe molekula te tjera
- C) formon kanale selective
- D) te gjitha me siper jane funksione te membranesh qelizore

V1

537. Vala P ne ECG tregon :

- A) .depolarizim te atriumeve

- B) depolarizim te ventrikujve para kontraksionit
- C) repolarizim te ventrikujve
- D) zemra ne qetesi

538. Toni i dyte i zemres ka vecorite e meposhtme,

pervec njeres:

- A) eshte ton diastolik
- B) eshte ton i forte
- C) eshte ton sistolik
- D) eshte ton i shkurter

539. Cila nga te meposhtmet nuk luan rol mbrojtës

ne traktin respirator:

- A) hunda
- B) goja
- C) epiteli respirator
- D) leukocitet

540. Me cilin lloj procesi transportohet glukoza prej proteines mbartese nga nje zone me perqendrim me te larte drejt nje zone me perqendrim me te ulet:

- A) transport aktiv
- B) endocitoze
- C) difuzion i lehtesuar
- D) difuzion i thjeshte

541. Dhembja T shfaqet:

- A) gjate depolarizimit te atriumit te majte
- B) gjate depolarizimit te ventrikulit te djathte
- C) ne fillim te sistoles atriale
- D) gjate repolarizimit te zemres

542. Ajri rezidual I mushkerive :

- A) matet me spirometer
- B) varion nga 2000-3000 ml
- C) quhet sasia e ajrit qe mbetet ne mushkeri pas nje frymenxjerrje te sforcuar
- D) quhet sasia e ajrit qe del gjate nje frymenxjerrje normale

PYETJET E SHENDETIT MJEDISOR

1. Studimi i descriptive:
 - A) Bejne vetem perskrimin e gjerave,
 - B) Nuk perdoren per studimin e ekspozimeve,
 - C) Nuk perdoren per studimin e efekteve,

D) Perdoren vetem per ekspozimet,

2. Studimet ekologjike:

- A) Njesia e analizës është individi,
- B) Janë të dobishme për gjenerimin e hipotezave,
- C) Vlerësohen të plota për përcaktimin e shkakesise,
- D) Janë të kushtueshme,

3. Kontrolli i ekspozimit ndaj FD në nivel personi:

- A) Duhet menduar si zgjidhja kryesore,
- B) Lidhet me numrin e personave të ekspozuar,
- C) Nuk ka të bëjë me rregullimin e kohës së ekspozimit,
- D) Nuk ka të bëjë me ndërrimin e detyrave,

V3

4. Indikatorët për monitorimin e riskut;

- A) Nuk ka vlerë besueshmëria,
- B) Nuk është e rëndësishme lehtësia e matjes,
- C) Nuk duhet të jenë të lidhur ngushtë me risqet,
- D) Duhet të shfaqen shpejt pas ekspozimit

V3

5. Kalimi i lëndëve toksike në gjak:

- A) Nuk lidhet me përqendrimin,
- B) Varet nga kohezgjatja e ekspozimit,
- C) Nuk lidhet me tretshmërinë e l. toksike në inde,
- D) Nuk varet nga sasia e ajrit të thithur,

V2

6. SO₂ si lëndë ndotëse në ajër:

- A) Efekti kryesor-dëmtimi i trurit,
- B) Nuk ka lidhje me reshjet acid,
- C) Ndotësi kryesor me përmbajtje squfuri,
- D) Është bërë problem vetëm dekadat e fundit,

V3

7. Fluoruret:

- A) Futen ne organizem kryesisht me ane te ushqimeve,
- B) Merren ma ane te ujit te pishem,
- C) Mungesa e tyre ne uje ul incidencene kariesit,
- D) Flurore me pakice-shfaqeje e flurozes,

8. FD e pranueshme e kimikateve me ane te ujit:

- A) Nuk garanton mbrojtjen e subjekteve vulnerable,
- B) Nuk merr ne konsiderate faktorete (pa) sigurise,
- C) Nivel nen te cilin nuk hasen efekte shendetesore,
- D) Nuk merr parasysh futjen e kimikatit ne rruge te tjera,

9. Pamjaftueshmeria e hekurit:

- A) Risku i anemise nuk eshte madh per grate,
- B) Nuk ndikohet nga parazitozat,
- C) Ndikohet nga dieta,
- D) Haset me shume ne vendet e zhvilluara,

10. Efektet shendetesore te pesticideve:

- A) Nuk prekin sistemin imun te organizmit,
- B) Nuk prekin organet e riprodhimit,
- C) Nuk demtojne lekuren,
- D) Kane efekte teratogjenike,

11. Strehimi dhe shendeti:

- A) Strehimi nuk ndikon mbi incidenat semundjeve ngjitese,
- B) Risku per Ca pulm nuk lidhet me strehimin,
- C) Shendeti psikosocial ndikohet nga dendesia e banimit,

D) Strehimi nuk ka te beje me aksidentet,

12. Efektet ekstraauditiv te zhurmave:

- A) Nuk lidhen me presionin arterial,
- B) Nuk ka crregullime te gjumit,
- C) Ndikon mbi sistemin imun,
- D) Rritja e iritabilitetit SNQ,

13. Programi i nje qyteti te shendetshem:

- A) Zgjedhjet jane multisektoriale,
- B) Rritje e pjesemarrjes ne vendimmarrje,
- C) Roli i publikut i paperfillshem,
- D) Nje akt dhe jo process ne vazhdimesi,

14. Lendet djegese te biomases:

- A) Nuk permbajne pjeseza te respirueshme,
- B) Permbajne (SO)_x,
- C) Problem ne vendet e varfera,
- D) Nuk permbajne HPA,

15. Faktoret gjenetike:

- A) Genet funksionojne pafundesisht,
- B) Ndikojne mbi vulnerabilitetin,
- C) Nuk ndikohen nga mjedisi,
- D) Asnjera nga pergjigjet,

16. Shendetit mjedisor:

- A) Nuk lidhet me kualitetin e jetes,
- B) Nuk ndikohet nga faktoret sociale,
- C) Ka lidhje me agjentet biologjike,
- D) Jo lidhje me shendetin e gjeneratave pasardhese,

17. Ekspozimi:

- A) Nuk merr ne konsiderate llojin e ndotesit,
- B) Ndikohet nga elementi kohe,
- C) Nuk ka lidhje me sasine e ndotesit,
- D) Nuk merr parasysh futjen e ndotesit,

18. Tranzicioni demografik:

- A) Lidhet me numrin e vdekjeve,
- B) Nuk ndikohet nga numri i lindjeve,
- C) Ndikon mbi numrin e popullates,
- D) Nuk ka lidhje me shendetin,

19. Problemet e shendetit mjedisor:

- A) Lidhen me migrimin, lindjet, etj,
- B) Nuk ndikohen nga varferia,
- C) Nuk lidhen me konsumin,
- D) Nuk ndikohen nga politikat makroekonomike,

20. Vleresimi I ekspozimit human:

- A) Doza matet me lehtesi,
- B) Me mire matja e perqendrimit,
- C) Doza e marre nuk varet nga vecorite e individit,
- D) Doza eshte ne funksion te kohes se ekspozimit,

21. Ligji i pare per Shendetin public:

- A) Merrej kryesisht me ndotjen industrial,
- B) Nuk merrej me problemet e ujit,
- C) Trajtonte rreziket nga semundjet ngjitese,

D) Asnjera nga pergjigjet,

22. Metodatat direkte te vleres se ekspozimit:

- A) Perfshijne metodatat matematikore,
- B) Perdoren aparatet vetiake te monitorimit,
- C) Perdoren pyetesoret,
- D) Perdoren ditaret e punetoreve,

23. Standartet mjedisore:

- A) Shume me te rrepta se ato profesionale,
- B) Nuk ndikohen nga grupet vulnerable,
- C) Risku profesional eshte ,me pak “ i pranueshem”,
- D) Asnjera nga pergjigjet

24. Varferia:

- A) Nuk ka lidhje me jetegjatesine
- B) Nuk lidhet me vdekshmerine foshnjore
- C) Nuk ndikon mbi incidencen e semundjeve ngjitese
- D) Ndikon mbi incidencen e paaftesise

25. Risku:

- A) Nuk eshte nje propabilitet
- B) Shfaqet kur ka patur nje ekspozim
- C) Eshte faktor qe mund te shkaktoje efekte shendetesor
- D) Asnjera nga pergjigjet

26. Doza efektive:

- A) Doza qe mund te vraste 50% te kafsheve
- B) Doza qe shkakton efekte ne 50% te kafsheve
- C) Merret vetem pas nje ekspozimi te zgjatur
- D) Asnjera nga pergjigjet

27. Fusha elektromanjetike:

- A) Eshte nje rezatim i llojit jonizues
- B) Nuk haste rreth linjave elektrike
- C) Shkakton kataraktin e syrit
- D) Mund te shkaktoje kancerin

28. Marredhania D-E:

- A) Lidhet me numrin e personave te prekur
- B) Lidhet me gravitetin e efekteve
- C) Nuk ekziston nje hierarki efektesh
- D) Asnjera nga pergjigjet

29. Vleresimi i ekspozimit human:

- A) Doza eshte e veshtire te matet
- B) Me mire matja e perqendrimet
- C) Doza e marre nuk varet nga vecorite e individit
- D) Doza nuk eshte ne funksion te kohes

30. Zhiva (Merkuri):

- A) Nxirret ne mjedis nga automjetet
- B) Perdoret si antiseptic/antifungal
- C) Nuk haset ne prodhimin e pasqyrave
- D) Nuk haset ne punimet e veshjes me ar

31. Indikatorët e shendetit mjedisor:

- A) ESH e perdourr duhet te shfaqet pas nje kohe te gjate
- B) Te jene te lidhur me risqet & ekspozimin
- C) Nuk ka rendesi lehtesia e matjes

D) Nuk ka vlere besueshmeria

32. Perfitim i drejtperdrejte nga menaxh. i nje ESHM”:

A) Nuk lidhen me jetet e fituara

B) Nuk kane te bejne me vitet e fituara te jetes

C) Nuk lidhen me vdekshmerine

D) Lidhen me kursimet ne sistemin shendetesor

33. Akumulimi I lendeve ndotese ne ajer:

A) Nuk lidhet me relievin e tokes

B) Nuk lidhet me levizjet e ajrit

C) Lidhet me rezatimin diellor

D) Nuk lidhet me inversionet temperaturore

34. Efektet e drejtperdrejta te NO:

A) Nuk ka efekte ne aparatin respirator

B) Efekt ne shperndarjen e gjakut ne mushkeri

C) Eshte ndotes dytesor

D) Asnjera nga pergjigjet

35. Semundjet qe perhapen me ane te ajrit:

A) Malarja

B) Ethet Dengue

C) Schistosomiaza

D) Tifoja

36. Futja ditore e pranueshme:

A) Nuk shkakton asnje efekt gjate jetes

B) Nuk shkakton asnje efekt gjate dites

C) Nuk duhet tejkaluar per asnje moment

D) Asnje nga pergjigjet

37. Osteoporozë e menopauzës:

- A) Nuk ndikohet nga rregullimet Endokrine
- B) Nuk ndikohet nga keqfunksioni , gastrintest
- C) Ndikohet nga ekspozimi ndaj kadiumit
- D) Asnjë nga të mëjjet

38. Efektet toksike të pesticidëve:

- A) Nuk lidhet me substancat mbajtëse
- B) Lidhen me rrugën e ekspozimit
- C) Nuk lidhen përberës që përmirësojnë absorbimin
- D) Nuk lidhet me dozën

39. Vendbanimet humane në ekosisteme:

- A) Nuk lidhen me furnizimin me ujë
- B) Nuk ndikohen nga ujërat e hapura
- C) Nuk lidhen me kushtet për jetën e egër
- D) Lidhen me qeverisjen lokale

40. Nivelet mesatare të ekspozimit:

- A) Të destinuara për ekspozimet 15 minuta
- B) Të destinuara për ekspozimet 8 orë
- C) Nuk duhen të jken për asnjë moment
- D) Asnjë nga të mëjjet

41. Ekosistemi i shëndetit:

- A) Nuk lidhet me burimet ujore
- B) Nuk lidhet me ajër
- C) Nuk ndikohet nga aktiviteti i njeriut
- D) Asnjë nga të mëjjet

42. Materiali gjenetik individual:

- A) Lehtesisht i ndikueshem nga ekspozimi mjedisor
- B) Ndikon ne vulnerabilitetin e subjekteve
- C) Funkcionon pa kufizim ne kohe
- D) Asnjera nga pergjigjet

43. Zhvillimit te qendrueshem:

- A) Nuk lidhet me ekonomine
- B) Lidhet me brezat e ardhshem
- C) Nuk lidhet me mjedisin
- D) Asnjera nga pergjigjet

44. Tranzicioni demografik:

- A) Nr. I vdekjeve eshte I ulet
- B) Nr. I lindjeve eshte I ulet
- C) Perben nje periudhe
- D) Perben nje moment

45. Rreziqet fizike:

- A) Rreziqet nga mjetet motorrike
- B) Rreziqet nga sportet
- C) Rreziqet nga rrezatimet
- D) Demtimet ne vendin e punes

46. Matja e mikroorganizmave ne shendetin shendetesor:

- A) Behet ne uje te pijshem
- B) Nuk perfshin analizen e ushqimeve
- C) Nuk perfshin analizen e tokes
- D) Asnjera nga pergjigjet

47. Studimet e toksicitetit akut:

- A) Perdoren per matjen toksicitet te lendeve
- B) Jane mjaftueshem per karakterizuar nga toksicitet, kimikat
- C) Perdoren per kancerogenet
- D) Nuk perfshijne DL50 dhe PL 50

48. Treguesi i viteve potenciale te humbura te jetes:

- A) Tenton te gjykoje humbjen e jetes humane
- B) Nuk lidhet me nr e viteve produktive te jetes qe humbasin
- C) Perdoret per te pershkruar humbjen e kontributeve
- D) Demtimet shpjegojne nje vogel te VPHJ

49. Vleresimi i ekspozimit:

- A) Nuk lidhet me identifikimin e burimit te ekspozimit
- B) Nuk llogaritet lenda e futur ne organizem
- C) Nuk nevojitet informacion demografik
- D) Asnjera nga pergjigjet

50. Vleresimi i riskut per efektet e pragut:

- A) Efektet nuk lidhen me dozen
- B) Si tregues i dozes nuk perdoret numri i viteve te ekspozimit
- C) Marredheniet D-P nuk perdoren per faktoret fizike
- D) Asnjera nga pergjigjet

51. Gjykimi mbi riskun:

- A) Nuk lidhet me vendimmarrjet
- B) I domosdoshem krahasimi me standartet
- C) Nuk lidhet me publikun
- D) Asnjera nga pergjigjet

52. Indikatoret ne shendetin mjedisor:

- A) Jane te domosdoshem ne monitorimin e riskut
- B) Nuk lidhen me jetegjatesine e pritshme
- C) Nuk perfshijne peshen ne lindje
- D) Nuk perfshijne vdekjet e parakohshme

53. Ndotja e ajerit:

- A) Nuk ndikohet nga inversionet temperatuore
- B) Nuk ndikohet nga relievi
- C) Nuk varet nga levizjet e ajerit
- D) Asnjera nga pergjigjet

V3

54. Lendet organike te avullueshme:

- A) Shkaktojne irritimin e aparatit respirator
- B) Nuk jane problem per ajerin e brendshem
- C) Nuk ndikojne ne krijimin e ozonit
- D) Asnjera nga pergjigjet

55. Kontrolli i cilesise se ajerit te jashtem:

- A) Lidhet me vendet e ndertimit
- B) Lidhet me kontrollin e emisioneve
- C) Nuk lidhet me transportin
- D) Nuk lidhet me energjine

56. Kualiteti i ujit te pijshem:

- A) Eshte i lidhur ngushte me sasine e ujit
- B) Nuk varet nga veprimtaria humane
- C) Nuk varet nga aktivitetet agrobujqesore
- D) Asnjera nga pergjigjet

57. Kerkesat energjitike te organizmit:

- A) Nuk maten me K Joul
- B) Nuk lidhen me permasat trupore
- C) Ndikohen nga klima
- D) Nuk varen nga gjendja fiziologjike

58. Zgjedhja e ushqimeve:

- A) Nuk lidhet me ndikimet kulturore
- B) Nuk varet nga mundesia e sigurimit te ushqimeve
- C) Nuk varet nga shija,era, paraqitja
- D) Varet nga kostoja dhe pershtatshmeria

59. Encefalopatia spongiforme:

- A) Shkaktohet nga nje bakter
- B) Shkaktohet nga nje ameba
- C) Ka si vektor kepushat
- D) Perhapet me ushqimin e gjedhit

60. Energjia & efektet direkte mbi shendetin:

- A) Jo rrezik te rendesishem profesional
- B) Jo stres psikologjik
- C) Ndryshime ekologjike
- D) Jo permiresim te vadijes

FAKULTETI I INFERMIERISE

Departementi Diagnostikes dhe Reabilitimit Shëndetesor

DEGA LOGOPEDI

**PROGRAMI I PYETJEVE TE KONTROLLIT TE DIJEVE
NE LENDET KLINIKE E PARAKLINIKE**

ANATOMI NORMALE

1. Brinjët e lira janë :

- A) I – II
- B) VII – VIII
- C) XI – XII
- D) VIII – IX

2.Fossa glenoidale ndodhet në :

- A) Brinjë
- B) Sternum
- C) Os.iliace
- d) Scapul

3.Eshtë pjesë e scapulës:

- A)Procesi zigomatik
- B)Procesi stiloid
- C) Procesi coracoid
- D)Procesi acromial

4.Te cilat kocka dallojmë : -Diafizen , Epifizën proximale dhe distale.

- A) Kockat e përziara
- B) Kockat spongioze
- C) Kockat sesamoide
- D)Kockat e shkurtra

5.Atlasi nuk ka :

- A) Trup
- B) Dy harqe
- C) fovea dentis
- D)tuberculum anterior

6.Facia aurikulare është pjesë e :

- A) Os. Costae
- B) Os. Mandibule
- C) Os. Clavicule
- D) Os. Sakrum

7.Fovea capitis ndodhet në :

- A) Os. Iliake

- B) Os. Mandibule
- C) Caput femuri
- D) Os. Sternum

8. Artikulacioni atlanto – oxipital është i tipit :

- A) Trochlear
- B) Cilindrik
- C) Elipsoid
- D) Selar
- E) Sferik

9. Artikulacioni costo – vertebral realizohet midis :

- A) Brinjës me acromion
- B) Scapula me proces coracoid
- C) Procesit transeversal të vertebrave me tuberkulave costale
- D) Capitulis costae me fovea costalis të trupit të vertebrave

10. Art. karmo- metacarpal bën këto lëvizje :

- A) Flexion – extension
- B) Pronacio – Supinacio
- C) Rrëshqitese
- D) Rotatore
- E) Abduxio – adduxio

11. Në M. suprahioid futen :

- A) M. platyzma
- B) M. digastricus
- C) M. scalen
- D) M. sternotiroid
- E) M. omohyoid

11. Janë muskuj të shpinës me përjashtim të :

- A) m. trapezius
- B) latissimus dorsi
- C) m. romboid
- D) m. levator- scapule
- E) M. deltoid

12. Muskujt e supit janë të gjithë ,me përjashtim të :

- A) m. deltoideus
- B) m. supraspinatus
- C) m. infraspinatus
- D) m. teres minor
- E) m. Latisimus dorsi

13. Janë muskuj të përparmë të kofshës:

- A) M . biceps femori
- B) M. semitendinos
- C) M. Quadriceps
- D) M. semimembranoz
- E) M. Popliteus

14. Janë muskujt medial të kofshës me përjashtim të muskulit:

- A) m. sartorius
- B) m. pektineus
- C) m. adductor- brevis
- D) m. adduktor magnus+ longus
- E) M. gracilis

15. Muskujt e përparmë të kërcirit janë:

- A) m. Gastroknemius
- B) m. soleus
- C) m. plantar
- D) m. tibial anterior

16. Muskujt e pasëm të kërcirit bëjnë :

- A) flexion të artikulacion të gjurit
- B) extension të artikulacion të gjurit
- C) abduktion të artikulacion të gjurit
- D) flexion plantar të artikulacion talo-krural

17. Muskuli deltoid kryen këto funksione kur kontrahetohen të tre degët e tij:

- A) rotacion të krahut
- B) flexion të krahut
- C) ngre krahun horizontalisht-abduktion
- D) extension të krahut

18. Artikulacioni C/F realizon këto lëvizje me përjashtim të :

- A) Flexion
- B) cirkumduzio
- C) extension
- D) adduxion

19. Artikulacioni S/H është artikulation i tipit :

- A) Elipsoid
- B) trochlear
- C) Sferik
- D) Enartrozis
- E) Cilindrik

20. Flexionin e artikulationit të gjurit e realizojnë muskujt:

- A) muskujt e përparme të kofshës
- B) muskujt e pasëm të kofshës
- C) muskujt e pasëm të kërcirit
- D) Muskujt medial të kofshës

21. Quhen muskujt të antigravitetit të ciëlt e marrin funksionin pas vitit të parë të jetës:

- A) M. e abdomenit
- B) M e përparmë të kofshës
- C) M. e pasëm të bacinit
- D) M e lateral të kofshës.

22. Muskujt e shpinës janë përvec njërit:

- A) M. trapezius ,
- B) M. latissimus dorsi (m i gjere)
- C) M. Pektoral
- D) M. Levator skapule
- E) M. Romboid

23. M. e anës së përparme të trungut (kraharorit) :

- A) M. Pectoral major +minor
- B) M. subclavius
- C) M. serratus anterior
- D) M. intercostal intern+extern
- E) M. subscapular

24. Diafragma është muskul që merr pjesë në :
- A) Flexion të kolonës
 - B) Extension të kolonës
 - C) Merr pjesë në frymëmarrje
 - D) Ndihmon në drejt qëndrimin e bustit.
25. Muskujt e anësor të barkut formojnë murin e lateral abdominal ,me përjashtim të :
- A) M.rectus abdomim
 - B) M. obliquus abdominis externus
 - C) M. obliquus abdominis internus
 - D) M. transversus abdominis
26. Janë kocka cifte të kafkës , me përjashtim të :
- A) Os. Temporale
 - B) Os. Maxillare
 - C) Os parietale
 - D) Os vomer
28. M. e qafës janë:
- A) M. Platysma
 - B) M. Supraspinata
 - C) M. infra spinata
 - D) M. teres major
 - E) M. subscapular
32. Muskujt përparmë të krahut quhen m. flektor dhe janë:
- A) M. Triceps brachi
 - B) M. Brachialis
 - C) M. anconeus
 - D) M. flexor carpi radial
33. Muskujt tibial posterior janë :
- A) M. extensor hallucis longus
 - B) M. soleus
 - C) M. extensor digitorum longus
 - D) M. Peroneus longus
34. Foosa poplitea ndodhet në :
- A) Në nivel të artikulacionit S/H
 - B) Në nivel të artikulacionit cubiti
 - C) Në nivel të artikulacionit genu
 - D) Në nivel të artikulacionit talo krural

35. Artikulacioni Cubiti realizohet midis:

- A) Trohlea humeri dhe incizura olekran e ulnës
- B) faies kondilare të tibies dhe kondileve femorale
- C) fossa acetabulare dhe kaput femori
- D) fossa glenoidale dhe kaput humeri

35. Artikulacioni coxo - femoral realizohet midis këtyre sipërfaqeve artikulare:

- A) fossa glenoidale me epifizën proximale të humerusit(kaput humeri)
- B) trochlea tali me sipërfaqen artikulare talare të tibies
- C) fossa acetabulare me kaput femori
- D) epifizës distale të radiusit me rreshtin proximal të karpeve

36. Artikulacioni genu kryen këto lëvizje :

- A) abduktion
- B) adduktion
- C) flexion
- D) cirkumduktion

37. Artikulacioni temporo- mandibular është artikulacioni midis:

- A) os oxipitale me atlasin
- B) os frontale me os parietale
- C) os sfenoidale me os temporale
- D) os mandibulare(kaput) me os temporale(fossa mandibulare)

38. Kockat e kafkës janë të palëvizhme me përjashtim të njërës :

- A) Os frontale
- B) Os mandibulare
- C) os sfenoidale
- D) os etmoidale

39. Gjuha është organ muskular që merr pjesë në :

- A) përthypje
- B) njomjen e ushqimit
- C) tretjen e ushqimit
- D) artikulum të fjalës

40. Area olfaktore ndodhet në :

- A) kavitetin e gojës
- B) kavitetin e hundës
- C) kavitetin e barkut
- D) në sipërfaqe të gjuhës

41. Pallatum molae ose qiellza e butë ka si funksion :

- A) artikulimin e fjalës
- B) përcjelljen e ushqimit
- C) mbyll orofaringun gjatë gëlltitjes
- D) mbyll nazofaringun gjatë gëlltitjes

42. Kordat zanore janë të vendosura në :

- A) ezofag
- b) faring
- C) laring
- D) trake

43. Nr. I unazave të trakesë është:

- A) 10 – 14
- B) 14 – 18
- C) 16 – 20
- D) 20 – 24

44. Në lobujt hepatic gjaku rrjedh :

- A) nga hapësirat portale drejt venave centrale
- B) nga venat centrale në hapësirat portale
- C) qarkullon brenda hapësirës portale
- D) qarkullon deri në venën centrale

45. Pankreasi është gjendër me sekrecion endokrin dhe exokrin dhe prodhon:

- A) Bilirubinë
- B) insulinë
- C) pepsinë
- D) HCL

46. Hepar vendoset në :

- A) hypokondrin e majtë
- B) hypokondrin e djathtë
- C) në hemitoraxin e majtë
- D) në hemitoraxin e djathtë

47. Në faqen inferiore të heparit del :

- A) nervi hepatic
- B) vena hepatica
- C) duktusi hepatic comun
- D) arteria hepatica

48. Duktus koledok derdh në duoden këtë lëng:

- A) Pankreatik
- B) biliar
- C) gastrik
- D) insuline

49. Eshtë pjesë e zorrës së holl ë

- A) zorra sigmoide
- B) duodeni
- C) rectumi
- D) procesi vermiforms

50. Sfinkter Oddi ndodhet në :

- A) në stomak
- B) në melci
- C) në duoden
- D) në ezofag

51. Pulmoni dexter ka :

- A) 1 lob
- B) 2 lobe
- C) 3 lobe
- D) 4 lobe

52. Në hilusin renal :

- A) futet nervat dhe venat renale, del a. renale dhe ureteri
- B) futet ureteri dhe a. renale, dalin nervat dhe a. renale
- C) futet v. renalis dhe ureteri, dalin nervat dhe a. renale
- D) futet a. renale dhe nervat, del ureteri dhe venat renale

53. Në hilusin pulmonar futet ,përvec :

- A) arteria pulmonare
- B) venat pulmonare

- C) bronket pulmonare
- D) nervat pulmonar

54. Njësia bazë funksionale e veshkës është:

- A) alveola
- B) glomeruli renal
- C) nefroni
- D) hepatociti

55. Ureterët kanë gjatësi:

- A) 15 cm
- B) 20 cm
- C) 25 cm
- D) 30 cm

56. Është shtersa e brendëshme e mitrës :

- A) perimetri
- B) endometri
- C) miometri
- D) parametrium

57. Zemra vendoset në :

- A) hemitoraxin e majte në mediastinin anterior
- B) hemitoraxin e majte në mediastinin posterior
- C) hemitoraxin e majte në mediastinin medial
- D) në hypokondrin e majtë

58. Në anën e majtë të zemrës ndodhen këta ostiume përvec:

- A) ostiumi aortal
- B) ostiumi i trungut pulmonar
- C) ostiumi i 4 venave pulmonare
- D) ostiumi atrio ventrikular i majtë

59. Janë cipa që mbështjellin zemrën :

- A) peritoneumi
- B) perikardi
- C) perimetri
- D) mediastini

60. Përmban gjak venoz të gjitha ,përvec:

- A) vena cava superior
- B) vena cava inferior
- C) venat pulmonare
- D) vena hepatica

61. Aorta e merr fillimin nga :

- A) atriumi i majtë
- B) atriumi i djathtë
- C) ventrikuli i majtë

D) ventrikuli i djathtë

62. Në vena cava superior derdhen gjakun venoz:

- A) vena porta
- B) venat ovariale
- C) venat iliake
- D) venat jugulare

63. Nga aorta torakale marrin fillimin e tyre:

- A) arteria subklavia
- B) arteria carotis externa
- C) arteria oftalmika
- D) arteria intercostale

64) Arteria brachiale është degë e :

- A) aortës torakale
- B) arteries axillare
- C) arteries carotis interna
- D) aortes abdominale

65. Arteria ezofageale e merr fillimin nga :

- A) aorta torakale
- B) arteria carotis externa
- C) arteria subklavia
- D) arteria carotis interna

66. Trunku coeliacus është degë e :

- A) aortës ascendente
- B) aortës torakale
- C) aortës abdominale
- D) harkut të aortës

67. Arteria ilaka interna ndahet në këto degë:

- A) arteria vezikalis superior dhe inferior
- B) arteria femoralis
- C) arteria tibialis anterior
- D) arteria poplitea

67. Arteria tibiale posteriore është degë e :

- A) arteries iliake interna
- B) arteries iliake externa
- C) aortës abdominale
- D) arteries carotis interna

68. Vena cava inferiore e derdhen gjakun venoz në :

- A) atriumin e majtë
- B) atriumin e djathtë
- C) ventrikulin e majtë
- D) ventrikulin e djathtë

69. Vena që bëjnë injeksionet intra vene në fossa cubiti quhet:

- A) vena axillare
- B) vena subclavia
- C) vena mediana cubiti

D) vena basilika

70. Vena më e madhe e extremiteteve të sipërme quhet:

- A) vena cephalika
- B) vena mediana
- C) vena basilika
- D) vena axillare

71. Derdhi gjakun venoz në vena cava superior:

- A) vena iliaka externa
- B) vena iliaka interna
- C) vena jugulare
- D) venat hepatika

73. Sistemi nervor qendror përbëhet nga:

- A) nervat spinal
- B) nervat cranial
- C) palca e kurrizit
- D) cipat e trurit

73. Nervat spinal për extremitetet e sipërme dalin në nivel të :

- A) C4 - Th1
- B) Th1 - Th12
- C) L1 - S3
- D) S4 - CO1

74. Nervat spinal për extremitetet e poshtëme dalin në nivel të :

- A) C4 - Th1
- B) Th1 - Th12
- C) L1 - S3
- D) S4 - CO1

75. Sa cifte nervash spinal janë:

- A) 12 cifte
- B) 24 cifte
- C) 31 cifte
- D) 34 cifte

76. Degët ngjitëse të nervave spinal janë rrugë :

- A) motore
- B) sensitive
- C) motore -sensitive
- D) asociative

77. Në truncus cerebri marrin pjesë :

- A) medula spinale
- B) ponsi
- C) cerebelumi
- D) ventrikuli i IV

78. Pons ose ura lidh midis tyre këto pjesë të trurit:

- A) sipër pons me trurin e madh
- B) poshtë me medulla spinale
- C) poshtë me medulla oblongata

D) pas me trurin e mesëm

79. Eshtë organ i ekulibrit, ndjeshmërise së thellë, i ekulibrit kjo pjesë e trurit:

- A) truri mesëm
- B) truri fundor
- C) medula oblongata
- D) truri i vogël

80. Lëngu cerebro spinal qarkullon nëpër :

- A) ventrikujt e trurit
- B) trurin madh
- C) trurin e vogël
- D) medula oblongata

81. Qendra kortikale e dëgjimit ndodhet në lobin :

- A) oxipital të truri të madh
- B) frontal të truri të madh
- C) temporal të truri të madh
- D) parietal të truri të madh

82. Morbus Parkinson vjen si pasojë e demtimeve të:

- A) të nervave kraniale
- B) të nukleuseve bazale –motorike të trurit të madh
- C) të trurit të vogël
- D) të pars oxipitale të trurit të madh

83. Realizon këto funksione sistemi komisural i trurit të madh:

- A) trasmeton impulsin nervor
- B) lidh giruse brenda një hemisfere
- C) lidh nukleuset midis pjesëve të ndryshme të trurit
- D) lidh hemisferën e majtë me hemisferën e djathtë

84. Në afazine motore Broca pacienti:

- A) nuk dëgjon
- B) nuk kupton
- C) nuk flet dot
- D) nuk përgjigjet saktë

85. Në afazine sensore - Wernicke pacienti:

- A) nuk flet dot
- B) nuk dëgjon
- C) nuk përgjigjet për atë që pyetet
- D) nuk artikulon dot fjalet

86. Nervat cranial janë:

- A) 10 cifte
- B) 12 cifte
- C) 14 cifte
- D) 16 cifte

87. Nervi optik është nerv:

- A) sensorial
- B) motor
- C) motor-sensitiv
- D) I perzier

88. Dëmtimi i nervit stato-akustik jep këto patologji:

- A) verbim
- B) humbje të nuhatjes
- C) humbje të ekulibrimit
- D) humbje të shijes

89. Nervi olfaktor është nerv që na jep impulse për :

- A) nuhatje
- B) shije
- C) shikim
- D) për presionin e gjakut

90. Dega për inervimin e muskulit sfinkter pupile është degë e nervit:

- A) abducens
- B) oculomotor
- C) trochlear
- D) hypoglossus

91. Nervi trigeminal është nerv:

- A) sensorial
- B) motor
- C) motor-sensitiv
- D) I përzier

92. Janë degë të nervit trigeminal:

- A) n. cochlear
- B) n. vestibular
- C) n. glosofaringeal
- D) n. maxillar

92. Nervi facial është degë e nervit:

- A) oculomotor
- B) stato-akustik
- C) intermedifacial
- D) optic

93. Nervi vag del nga kafa nëpërmjet forame jugulare së bashku me nervin:

- A) optic
- B) glosofaringeal
- C) abducens
- D) trigemini

94. Nervat spinal janë vetëm nerva:

- A) motor
- B) sensitiv
- C) sensitivo-motor
- D) asociativ

95. Plexusi i krahut formohet nga degët e përparme të nervave:

- A) C4-C7
- B) C7 – Th1
- C) Th1 -Th4
- D) C5- Th 1

97. Dëmtimi i kujt nervi i jep dorës pamjen e "kthetrës së maces":

- A) n. supraclavikular
- B) n. radial
- C) n. ulnar
- D) n. median

98. Dëmtimi i kujt nervi jep pamjen e "gishtave të obsetrit" ose "të marrjes leje":

- A) n. supraclavikular
- B) n. radial
- C) n. ulnar
- D) n. median

99. Nervi ischiaticus është degë e plexit:

- A) brachial
- B) lumbar
- C) sacral
- D) coccygeal

100. Nervi ischiaticus shërben për inervimin e :

- A) m. Extensiv të kercirit
- B) m. e pasëm të kofshës
- C) lëkurën e kofshës
- D) m. medial të kofshës

101. Prodhon hormonin e rritjes gjendra e:

- A) paratiroides
- B) epifiza
- C) hypofiza
- D) tiroides

102. Cili hormone kontrollon % e Ca në kocka:

- A) parathormoni
- B) calcitonina
- C) insulina
- D) tiroxina

103. Morbus Basedov shfaqet kur kemi :

- A) hiper funksion të tiroides
- B) hipo funksion të tiroides
- C) hiper funksion të tiroides
- B) hipo funksion të tiroides

104. Rregullon metabolizmin e K, Na, në organizmin e njeriut hormoni i :

- A) paratiroides
- B) tiroides
- C) suprarenales
- D) epifizes

105. Hormoni hipofizës (neurohipofiza) ka si funksion:

- A) rritjen e trupit
- B) shton diurezën
- C) zgjeron enët e gjakut
- D) ngushton enët e gjakut

107. Futet në hormone mashkullore:

- A) estrogenet
- B) folikulostimulues
- C) testosteroni
- D) prolaktina

108. Rritja e sasisë së insulinës në gjak shkakton sëmundjen e :

- A) gjigantizëm
- B) diabet mellitus
- C) diabet insipid
- D) miksedemë

109. Tetania shkaktohet nga mungesa e Ca në gjak e cila vjen nga :

- A) rritja e hormonit të tiroides
- B) rritja e hormonit të paratiroides
- C) ulja e hormonit të tiroides
- D) ulja e hormonit të paratiroides

110. Nanizmi vjen si pasojë e :

- A) rritja e hormonit të hipofizës
- B) rritja e hormonit të epifizës
- C) ulja e hormonit të hipofizës
- D) ulja e hormonit të epifizës

111. Janë pjesë të veshit të brendshëm:

- A) malleus(cekici)
- B) incus(kudhra)
- C) cochlea
- D) stapes(yzengjia)

112. Janë pjesë të veshit të mesëm:

- A) kanalet semicirkulare
- B) incus(kudhra)
- C) cochlea
- D) organi i Kortit

113. Janë pjesë të tunika vaskuloza(uvea) të syrit:

- A) irisi
- B) sklera
- C) kornea
- D) kristalini

114. Tunika nervoza bulbi përbëhet nga :

- A) chorioidea
- B) irisi
- C) gjendrat lakrimale
- D) retina

115. Retina përmban disa lloje qelizash që janë :

- A) 1 tip qelizash
- B) 2 tipe qelizash
- C) 3 tipe qelizash
- D) 4 tipe qelizash

HISTOLOGJI

41. Për ribozomet nuk është e vërtetë që:

- A) Në to kryhet sinteza e proteinave
- B) Përmbajnë ARN
- C) Përbëhen nga subuniteti i madh dhe i vogël
- D) S' përmbajnë proteina strukturore

42. Nuk është e vërtetë që bërthama:

- A) Ka përmasa të ndryshme në qeliza të ndryshme
- B) Ka formë të ndryshme në qeliza të ndryshme
- C) përmban material gjenetik në trajtë të ADN
- D) vendoset gjithmonë në qendër të qelizës

43. Gjenerimi i qelizave të gabuar për indin epitelial:

- A) Ka pozicion kufitar
- B) Ka enë gjaku
- C) Ka veti rigjeneruese
- D) Ka polaritet të theksuar në disa lloje qelizash

44. Cili pohim është i gabuar për ADN:

- A) Gjetet vetëm në bërthamë
- B) Shoqërohet nga proteinat histone
- C) Organizohet në kromozome
- D) Organizohet në kromatinë

45. Formimi i njëkohshëm i eritrocitit, trombocitit dhe granulociteve realizohet në:

- A) Nyjen limfatike
- B) Lien
- C) Palcën e kuqe të kockave
- D) Hepar

46. Për neuronin është e gabuar që:

- A) është njësia morfologjike dhe funksionale e indit nervor
- B) nuk kanë aftësi të shumohen
- C) aksonet e tij përmbajnë lende tigroide
- D) dendritet janë më të shkurtër se aksoni

47. Për pankreasin është e gabuar që:

- A) ka funksion endokrin dhe ekzokrin
- B) indi ekzokrin paraqitet ne trajten e ishujve te langehansit
- C) pjesa ekzokrine përbën pjesën më të madhe të gjendrës d: pjesa endokrine prodhon glukagon

48. Në veshkë sintetizohen substancat e mëposhtme, përveç:

- A) Reninës
- B) Eritropoetinës
- C) Aldosteronit
- D) Angiotensinogjenit

49. Epiteli i kavitetit oral është:

- A) Më i keratinizuar i trupit të njeriut
- B) Pseudo-shumështresor prizmatik
- C) I mbuluar në sipërfaqe nga indi muskolor
- D) Shumështresor i sheshtë

50. Cili është pohim i gabuar për kompleksin golxhi:

- A) vendoset përballë bërthamës
- B) është më i shprehur në qelizat sekretore
- C) në to kryhet trafiku më i madh i makromolekulave
- D) ndërmjet tij dhe rep-it ka komunikim direkt

51. Gjeni pohimin e gabuar në lidhje me bërthamën:

- A) Madhësia e saj është e ndryshme në qeliza të ndryshme
- B) Qelizat kanë gjithmonë vetëm një bërthamë
- C) Ajo mund të gjendet në dy gjendje fizike
- D) Kromatina është përbërja kryesore e bërthamës

52. Cila nga qelizat e mëposhtme nuk është autoktone në indin lidhor:

- A) Fibroblastet
- B) Eozinofilet
- C) Qelizat mezenkemale
- D) Mastocitet

53. Për eritrocitet është e gabuar që:

- A) Kanë bërthamë
- B) Përmbajnë proteinën hemoglobinë
- C) Kanë formën e diskut bikonkav
- D) Kanë funksion transportin e oksigjenit dhe dioksidit të karbonit

54. Për eozinofilet nuk është e vërtetë që:

- A) Bëjnë pjesë në seritë granulocitare
- B) Kanë granula specifike me nuancë portokalli
- C) Kanë bërthamë të rrumbullakët
- D) Rritja e numrit të tyre quhet eozinofili

55. Cili funksion nuk i përket neuroglisë:

- A) mbështetës
- B) ushqyes
- C) përcjellës
- D) kufizues

56. Cilat qeliza nuk përbëjnë mukozën e kavitetit nazal:

- A) olfaktore
- B) parietale
- C) mbështetëse
- D) kaliciforme

57. Në lëkurën e hollë mungon shtresa:

- A) Bazale
- B) E shndritshme
- C) Kokrrizore
- D) E brirëzuar

58. Gjени pohimin e gabuar mbi uterusin:

- A) Përbëhet nga tre shtresa
- B) Është vendi i implantimit të vezës së fekunduar
- C) Epiteli i tij përbëhet nga dy shtresa
- D) Shtresa muskulore është më e holla

59. Fibrocitet kanë tipar karakteristik:

- A)Praninë e zgjatimeve të shumta citoplazmatike
- B)Organelet citoplazmatike të zhvilluara
- C) Formën boshtore të bërthamës
- D) Bërthamën eukromatinike

60. Eritrocitet kanë tipar karakteristik:

- A) Gjatësinë 60-80 milimetër
- B)Ngjyrën blu të bërthamës
- C)Diametrin 7-8 mikrometër
- D) Formën bikonvekse

61. Bazofilia:

- A)Është mungesa e qelizave bazale
- B)Nuk egziston sepse bazofilet përbëjnë më pak se 1% të leukociteve
- C)Është ulja e sasisë së bazofileve
- D) Është rritje e numrit të bazofileve

62. Palca e kockave nuk ka funksion:

- A) Hematoklazik
- B)Lokomotor
- C)Retikulo-endotelial
- D) Hemopoetik

63. Fijet muskulare të skeletit në prerje tërthore janë:

- A) Me formë poligonale
- B)Me pamje të vijëzuar
- C)Pa bërthamë
- D) Me bërthamë në qendër të qelizës

64 Qelizat e mikroglisë në sistemin nervor qendror janë:

- A)Me funksion përcjellës
- B) Me origjinë nga indet muskulor
- C)Me funksion fagocitar
- D) Përbërëse të mielinës

65. Mukoza olfaktore në kavitatin nazal mbulon:

- A)Gjithë sipërfaqen

- B) Pjesën superiore
- C) Pjesën më të madhe
- D) Pjesën inferiore

66. Gjendrat sublinguale:

- A) Prodhojnë sekrecion të përzier
- B) Prodhojnë sekrecion vetëm seroz
- C) Nuk kanë gjysmehënëza të xhianucit
- D) Kanë qeliza centroacinare

67. Në përbërje të acinusit pankreatik marrin pjesë edhe:

- A) Ishujt e langerhansit
- B) Qelizat sertoli
- C) Qelizat centroacinare
- D) Qelizat beta

68. Në glomerula:

- A) Përqëndrohet urina
- B) Ka qeliza mezangiale
- C) Nuk ka podocite
- D) Sintetizohet eritropoetina dhe renina

69. Në terrenet qelizore nuk nevojiten:

- A) Kushtet aseptike
- B) Antinflamatorët
- C) Bujonet organike
- D) Antibiotikët

GJENETIKË MJESORE

1. Sëmundja kromozomike që karakterizohet nga labiopalatoskiza, prapambetje mendore dhe fizike:

- A) sindroma Down
- B) sindroma Turner
- C) sindroma Patau
- D) sindroma Klinefelter

2. Në grupin e gjakut AB:

- A) A është dominante ndaj B
- B) B është reçesive ndaj A
- C) B dhe A janë kodominante
- D) Gjysma e qelizave shfaqin antigenin A dhe gjysma tjetër antigenin B

3. Një gjenotip XO shfaqet në:

- A) sindromën Patau
- B) trizominë 21
- C) sindromën Klinefelter
- D) sindromën Turner

4. Ato linden si rrjedhojë e dy thyerjeve në krahët e kromozomit dhe kthimin e fragmentit 180 gradë në vetvete.

- A) Izokromozomet
- B) Translokacionet
- C) Delecionet Intersticiale
- D) Inversionet

5. Cilat nga Sindromat e mëposhtme është sindromë gjenetike që rrjedh nga delecionet:

- A) S. down
- B) S. chri-du-cat
- C) S. Patau
- D) S. Edwards

6. Individët me këtë sëmundje shfaqin anoreksi, infeksione pulmonare dhe nivel të lartë kripe në djersë:

- A) neurofibromatoza
- B) hiperkolesterolemia
- C) spina bifida
- D) Fibroza Cistike

7. Cila nga sëmundjet e mëposhtme tejçohet në mënyre reçesive e lidhur me X?

- A) Akondroplazia
- B) Albinizmi Okular
- C) Hemofilia B
- D) Raketizmi rezistent ndaj vitamines D

8. Një pacient/e paraqet pilozitet të pakësuar, hipogonadizm, inteligjencë normale, gjinekomasti (zmadhim gjiri). Dysshojmë për Sindromën:

- A) Klinefelter
- B) Edwards

- C) Down
- D) Turner

9. Në një qelizë me një numer $2n+1$ kromozomesh, kemi të bëjme me:

- A) aneuploidi
- B) monozomi
- C) triploidi
- D) trizomi

10. Cila prej zgjedhjeve të mëposhtme tregon që kemi të bëjmë me një trashëgimi autosomike recesive?

- A) Sëmundja prek më shumë meshkujt sesa femrat
- B) Tipari zakonisht shfaqet në pasardhësit e prindërve të prekur
- C) Teçimi horizontal i tipareve në gjeneratat familjare
- D) Teçimi vertikal i tipareve në gjeneratat familjare

11. Sindroma Down ka:

- A) Defiçiençë imunitare
- B) mekanizmi gjenetik në mbi 90% të rasteve është mosshkëputja e kromozomeve në mejozë
- C) facies lunata
- D) të gjitha

12. Në qoftë se një çift ka një fëmijë me sëmundjen e Fibrozës Sistike, shansi për të pasur një fëmijë tjetër të prekur nga kjo sëmundje është:

- A) 10%
- B) 25%
- C) 50%
- D) 75%

13. Në mitozë, qelizat me 16 kromozome prodhojnë qeliza bija ku secila ka:

- A) 32 kromozome
- B) 8 kromozome
- C) 16 kromozome
- D) 16 çifte kz.

14. Në mejozë, qelizat me 32 kromozome prodhojnë qeliza bija ku secila ka:

- A) 32 kromozome
- B) 8 kromozome

- C) 16 kromozome
- D) 4 çifte kz.

15. Në qoftë se një çift ka një femijë me semundjen e hiperkolesterolemise familjare e cila është autozomike dominante, shansi për të pasur një femije tjetër të prekur nga kjo sëmundje është:

- A) 10%
- B) 25%
- C) 50%
- D) 75%

16. Me çfarë mutacioni kemi të bëjmë më poshtë?

ATGCATTCA----- Sekuenca e ADN-së normale.

ATGCATCCA----- Sekuenca e ADN-së mutante.

- A) Frameshift
- B) Zëvendësim i guanines me citozinën
- C) Transversion
- D) Tranzicion

17. Cila nga mëposhte është e vërtetë në një individ heterozigot për antigjenin A dhe B?

- A) gjenotipi AO
- B) A është recesive ndaj B
- C) Prania e antitropave A dhe B
- D) Nuk ka asnjë nga antitropat A dhe B

18. Hiperkolesterolemia familjare është:

- A) sëmundje autozomale recesive
- B) shfaqet më shpesh nga lidhja martesore Aa x Aa
- C) është e pa-pajtueshme me jetën
- D) asnjë nuk është e vërtetë

19. Çfarë tipi mutacioni ka ndodhur në sekuencën e mëposhtme:

ATAGCAATTCTAG---- Sekuenca e ADN-së normale

ATAGCAAATTCTAG—Sekuenca e ADN-së mutante.

- A) Pa sens
- B) Zëvendësim i bazës adenine në pozicionin e 6-shtë
- C) Neutral
- D) Frameshift

20. Është një çrregullim i rëndë i metabolizmit të purinave që shoqërohet me efektet klinike të prapambetjes mendore dhe tendencës për vetëshkatërim:

- A. Tay-sachs
- B. Galaktozemia

- C. Lesch-Nyhan
- D. Alkaptonuria

21. Sëmundje autozomike recesive në të cilën enzima Fenilalaninë hidroksilaza është defektoze:

- A) Alkaptonuria
- B) Homosistinuria
- C) Albinizmi
- D) Fenilketonuria

22. Cila nga hipotezat e mëposhtme është më e sakta për sa i përket produktit të një gjeni:

- A) Një gjen-një proteine
- B) Një gjen-një sheqer
- C) Një gjen-një ADN
- D) Një gjen-një tipar

23. Sëmundje e shkaktuar nga mungesa e sintezës të enzimës Tirozinazë:

- A) Fenilketonuria
- B) Sistinuria
- C) Alkaptonuria
- D) Albinizmi

24. Prania e një njolle me ngjyrë qershie në retinë, qorrimi dhe humbja në rritje e të dëgjuarit janë të gjithë tregues të sëmundjes:

- A) Feminizmi testicular
- B) Tay-sachs
- C) Fenilketonuria
- D) Lesch-Nyhan

25. Cilat nga karakteristikat e mëposhtme i përket ADN-së por jo ARN-së?

- A) Filamenti i saposintetizuar është antiparalel me filamentin shabllon?
- B) Filamentet e reja sintetizohen në drejtim 5'-3'
- C) Sinteza është gjysëm-konservative
- D) Formon struktura sekondare komplekse

26. Çfarë karakteristike kanë të përbashket ADN-ja me ARN-në?

- A) Janë të lokalizuara në bërthamë
- B) Përmbajnë dezoksiribozën si sheqerin e tyre

- C) Janë molekula me strukturë dy-fijore
- D) Përmbajnë lidhje fosfodiesterike

27. Mejoza:

- A) Ndodh në të gjitha qelizat që përbejnë organizmin
- B) Është e përberë nga një ndarje e vetme
- C) Ndodh vetëm në qelizat e linjës seksuale
- D) Prodhon 4 gametë haploide si tek meshkujt ashtu edhe tek femrat

28. Nga sa kopje kromozomesh përbëhet kariotipi human normal?

- A) 23
- B) 24
- C) 22
- D) 20

29. Një kromozom metacentrik është një kromozom:

- A) Pa strukturë centromerike
- B) Me dy centromere
- C) Me një centromer të vendosur shumë afer pjesës fundore të kromozomit
- D) Me një centromer të vendosur në qendër të kromozomit

30. Molekula e ARN-së:

- A) Nuk përmban molekula sheqeri
- B) Përmban bazën pirimidine timine
- C) Ndodhen vetëm në citoplazmën e qelizave
- D) Ndodhet si në citoplazëm ashtu edhe në bërthamë

31. Një kampion ADN-je dy-fijore ka një përbërje prej 20% adenine. Sa është përmbajtja në përqindje e citozinës?

- A) 20%
- B) 30%
- C) 40%
- D) 60%

32. ADN-ja nuk mund të analizohet nga:

- A. Eritrocitet
- B. Nga sistemi nervor
- C. Spermatozoidet
- D. Floket

33. Çfarë lidhjesh kimike lidhin dy nukleotide të njëpasnjëshme përgjatë një filamenti të acidit nukleik?

- A) Lidhjet fosfodiesterike
- B) Lidhjet peptidike
- C) Lidhjet polare
- D) Lidhjet hidrogjenore

34. Specificiteti i lidhjeve të kopjeve AT dhe GC është e përcaktuar nga:

- A) Lidhjet kovalente
- B) Lidhjet hidrogjenore
- C) Lidhjet disulfurike
- D) Lidhjet glikozilike

35. Një delecion i krahut të madh të kromozomit 15 i shoqëruar me efektet klinike të obezitetit dhe të prapambetjes mendore është karakteristike e sindromës:

- A) Klinefelter
- B) Turner
- C) Monozomia 4p
- D) Prader-Willi

PYETJET E LENDEVE KLINIKE

NEONATOLOGJI

